




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT  
PËRMBARUESE GJYQËSORE PRIVATE "ENSOLA KUÇI"

Nr.4178/Prot.

Tiranë, me dt.28/09/2021



U R D H Ë R

VENDOSJE SEKUESTRO KONSERVATIVE

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit

TIRANË

Për Dijeni : **Debitori, Sh. "Leti Construction" Sh.p.k, përf.Ervis Leti**

Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Godina 7/1, Kati 2

TIRANË

Të nderuar zotërinj!

Unë, përmbarese gjyqësore private Ensola Skënder Kuçi, me Nr. certifikate 225, regjistruar në QKR me Nr. NIPT:L51801021A, pasi studiova materialet e dosjes përmbarese Nr.1071/Regj, bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit Vendimin nr. 7100/Regj, datë 15.07.2021, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë,

**KONSTATOVA:**

Se me datë; 10.09.2021 është depozituar pranë përmbarese gjyqësore private "Ensola Kuçi", kërkesa e kreditorit, Shoqëria Tregtare "Haki Sinani" sh.p.k, përfaqësuar me Prokurë nga Studio Ligjore "Angelus Lex" sh.p.k, së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit, lëshuar për Titullin Ekzekutiv, Faturat tatimore të shitjes Nr.15067 datë 18.11.2020, Nr.16555 datë 14.12.2020, dhe Nr.16970 datë 21.12.2020, me palë dhe objekt:

**Kreditor : Shoqëria "Haki Sinani" Sh.p.k**

**Debitor : Shoqëria "Leti Construction" Sh.p.k**

**Objekti : Pagim detyrimi**

Zyra përmbarese, në mbështetje të nenit 517 të K. Pr. Civile, ka dërguar në drejtim të palës debitore lajmërimin për ekzekutim vullnetar. Megjithatë

Adresa: Rr."Brigada VII", Pall 8, Hyrja 2, Kati 2, Tiranë Cel.0682000133,email:kuciensola@gmail.com.

pala debitore ka marrë dijeni, nuk ka vepruar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 517 të K. Pr. Civile. Për rrjedhojë, në mbështetje të nenit 519 të K. Pr. Civile, ekzekutimi i titullit ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Sa sipër, për efekt të ekzekutimit të titullit ekzekutiv dhe në mbështetje të nenit 527 të K. Pr. Civile, duhet të urdhërohet vendosja e masës së sekuestros mbi kuotat/aktivet e palës debitore.

### **URDHËROJ;**

Vendosjen e masës së sekuestros mbi aktivet/kuotat e palës debitore **Shoqëria "Leti Construction" Sh.p.k me NIPT; L71305061M, me qëllim ndalimin e tjetërsimit të tyre deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit.**

Sekuestro duhet të vendoset në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit Vendim nr. 7100/Regj, datë 15.07.2021, i Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke respektuar rradhën e preferimit, bazuar në nenin 605 të K.Civil.

Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

*Lutemi bashkalidhur do të gjeni kopje të Urdhërit të Ekzekutimit*

### **PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT**

**ENSOLA S. KUÇI**



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË

NR.REGJ.THEM. 7100

Data e regjistrimit 07.06.2021

Data e vendimit 15.07.2021

**V E N D I M**

**“Për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

**GJYQTARE : FIDA OSMANI**

Asistuar nga sekretare gjyqësore Kledjana Llalla, në Tiranë me 15.07.2021 shqyrtoi në dhomë këshillimi kërkesën civile që i përket :

**KËRKUES:**

Shoqëria Tregtare “HAKI SINANI” sh.p.k. me administrator z.Haki Sinani, regjistruar në QKR, me Nr.NIPT: K31519538K, me seli në Durrës, Xhafzotaj, SALLMONE, Autostrada Tiranë Durrës, Km. 26, Zona Kadastrale 3255, Nr. Pasurie 60/51, Ndërtesë 5 katëshe, përfaqësuar me prokure nga Studio Ligjore “ANGELUS LEX” shpk me NIPT L51713007A, me seli në Rrugën “Sami Frashëri”, Nd 30, H 7, Ap 9, Tiranë

**OBJEKTI:**

1. Kërkohet lëshimi i Urdhërit të Ekzekutimit për debitorin Shoqërinë “LETI CONSTRUCTION” shpk me NIPT L71305061M me seli në Rrugën “Ismail Qemali”, Godina 7/1, kati 2, Tiranë, me Administrator Ervis Leti, për Faturat Tatimore të Shitjes së mëposhtme:

- Fatura Tatimore e Shitjes Nr 15067 datë 18.11.2020 në shumën 32 100 (*tridhjetë e dy mijë e njëqind*) Lekë;
- Fatura Tatimore e Shitjes Nr 16555 datë 14.12.2020 në shumën 91 478 (*nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë*) Lekë;
- Fatura Tatimore e Shitjes Nr 16970 datë 21.12.2020 në shumën 38 260 (*tridhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë*) Lekë;

2. Si dhe kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

**BAZA LIGJORE:** Neni 510,511 paragrafi i fundit (*i ndryshuar me Nenin 3 të Ligjit Nr. 114 i vitit 2016*) të K.Pr.Civile, dhe Neni 16 i Ligji 48/2014 “Për pagesat e vonuara në Detyrimet Kontraktore Tregtare”

Gjykata mbasi shqyrtoi aktet e bisedoi çështjen

### VËREN

Se, pala kërkuese, Shoqëria “Haki Sinani” shpk, me nr NIPT K31519538K, me administrator Haki Sinani, si objekt të veprimtarisë së saj ka: “*Tregëtim me shumicë e pakicë të mallrave industrial, ushqimor, lëndë të parë, hidraulike, kancelari për zyra e shkolla, mobilje, produkte deti. Agjenci turistike e prerje biletë për udhëtime jashtë vendit. Tregëtim me shumicë e pakicë të materialeve të ndërtimit inport-eksport. Hoteleri-turizëm. Bar-kafe- restorant...*”

Shoqëria “Haki Sinani” shpk ka hyrë në një mardhënie kontraktore me Shoqërinë “Leti Construction” shpk me NIPT L71305061M me seli në në Rugën “Ismail Qemali”, Godina 7/1, kati 2, Tiranë, me Administrator Ervis Leti, për furnizimin me mallra. Për furnizimet e kryera Shoqëria “Haki Sinani” shpk, ka lëshuar Faturat Tatimore të Shitjes në të cilat evidentohet lloji i mallit të furnizuar, sasia dhe çmimi i tyre. Shoqëria “Leti Construction” shpk, ka marrë në dorëzim dhe ka përfituar nga mallrat e furnizuar, dhe nuk ka paguar detyrimin për Faturat Tatimore Shitje të sipërcituara në objektin e kërkesës.

Fakti që ndërmjet palëve ka ekzistuar një mardhënie juridike kontraktore vërtetohet nëpërmjet Faturave Tatimore të Shitjes në të cilat evidentohet qartë malli i furnizuar, sasia, të dhënat e transportuesit të mallit, marja në dorëzim nga ana e Shoqërisë “Leti Construction” shpk, librit të Shitjeve që vërtetohet se faturat korrespoduese janë deklaruar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve dhe është bërë pagesa e TVSH, Kartelës së Klientit në të cilën evidentohet e gjithë marrëdhënia kontraktore si dhe nëpërmjet komunikimeve ndërmjet palëve. Pala kërkuese nëpërmjet komunikimeve të shumta me Shoqërisë “Leti Construction” shpk është përpjekur që ta zgjidhë me mirëkuptim mosmarrëveshjen në lidhje me Faturat Tatimore të papaguara. Njoftimi i fundit zyrtar është kryer me shkresën Nr 1791 Prot datë 22.04.2021 “Kërkesë Për pagimin e Faturave Tatimore”, por nga pala debitore nuk ka patur asnjë reagim. Detyrimet e Faturave Tatimore të Shitjes janë të njohura, të përcaktuara saktë, të kërkueshme, nuk lidhet me plotesimin e afateve dhe kushteve të caktuara dhe mbi të gjitha është i pakushtëzuar nga rrethana të tjera apo nga detyrime të tjera mes palëve të sipërcituara.

Neni 511 i këtij kodi, paragraf i shtuar me Ligjin Nr.114.2016 parashikon se: “*Shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit zhvillohet nga gjyqtari pa praninë e palëve. Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit, bazuar mbi dokumentet e depozituara nga kërkuesi...*”, për rrjedhojë kjo kërkesë u mor në shqyrtim nga Gjykata në dhomë këshillimi pa prezencën e palës kërkueses, dhe në marrjen e vendimit u shqyrtuan vetëm aktet e bashkangjitura kërkesës.

Cilësinë e titullit ekzekutiv, në kuptim të dispozitave procedurale mbi ekzekutimin e detyrueshëm, e kanë vetëm aktet e përcaktuara në nenin 510 të K.Pr.Civile. Gërma “e” e këtij neni parashikon si tituj ekzekutivë edhe aktet që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e tyre.

Ligji nr. 48.2014 në nenin 16 parashikon se “Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur:

a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe  
b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.

2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile”.

Në rastin në shqyrtim jemi përpara detyrimeve monetare të përcaktuara në faturë tatimore të shitjes, nga përmbajtja e së cilës vërtetohen të dy kërkesat e nenit 16 të ligjit-a) kreditori ka lëvruar mallrat apo **kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit**; dhe b) **debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin**. Kryerja e shërbimit, vërtetohet plotësisht nga aktet që shoqërojnë kërkesën, libër shitje, ditar klienti, si dhe nga përmbajtja e faturës tatimore të shitjes, e cila është nënshkruar rregullisht nga pala debitore, që provon edhe pranimin prej tij të këtij detyrimi.

Gjithashtu plotësohet edhe kërkesa e nenit 15 të ligjit - *detyrimi që ka të bëjë me furnizimin e kryer për mallra.shërbime, ka lindur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji (ligji ka hyrë në fuqi me datë 05.06.2014).*

Në vështrim të nenit 511 të K.Pr.Civile: “*Urdhri i ekzekutimit përmban: a) gjenealitetet e debitorit dhe kreditorit; b) origjinën e detyrimit; c) detyrimin konkret që buron nga titulli ekzekutiv deri në momentin e lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit; d) kur titulli ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhri i ekzekutimit, është akt për dhënie kredie bankare ose detyrime monetare, Gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”.*

Në rastin në shqyrtim, u vërtetua ekzistenca e këtyre elementeve dhe pikërisht, gjenealitetet e debitorit dhe kreditorit, origjina e detyrimit dhe detyrimi konkret në momentin e lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit.

Sa sipër duke qënë se shoqëria “Leti Construction” sh.p.k., rezulton të jetë debitore ndaj palës kërkuese, ky detyrim provohet me faturat tatimore të shitjes, si dhe duke qënë se në kuptim të dispozitave procedurale të sipërcituara detyrimi sipas faturave përbën titull ekzekutiv, pasi ka lindur përpara hyrjes në fuqi të ligjit, gjykata vlerëson se faturat tatimore të shitjes, për të cilat kërkohet lëshimi i urdhrimit të ekzekutimit ka cilësinë e titullit ekzekutiv, që i nënshtrohet ekzekutimit të detyrueshëm mbi bazën e urdhrimit të ekzekutimit të lëshuar nga gjykata.

Përsa i përket katave ligjore pas momentit të lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit deri në momentin e ekzekutimit, do të përcaktohen dhe llogariten në

përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht sipas nenit 5 të ligjit nr.48.2014,  
“Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata në mbështetje të neneve 510 e vijues të K.Pr.Civile,

## VENDOSI

Pranimin e kërkesës së palës kërkuese shoqëria “Haki Sinani” sh.p.k.  
Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për pjesën e pashlyer të detyrimit që rrjedh  
nga faturat tatimore të shitjes:

- Nr. 15067 datë 18.11.2020 në shumën 32,100 (tridhjetë e dy mijë e njëqind) Lekë;
- Nr. 16555 datë 14.12.2020 në shumën 91,478 (nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) Lekë;
- Nr. 16970 datë 21.12.2020 në shumën 38,260 (tridhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) Lekë,

të lëshuara nga shoqëria “Haki Sinani” sh.p.k., kundrejt subjektit debitor, shoqëria  
“Leti Construction” shpk me NIPT L71305061M me seli në në Rrugën “Ismail  
Qemali”, Godina 7/1, kati 2, Tiranë, me Administrator Ervis Leti, si dhe kamatat  
ligjore, në bazë të nenit 5 të ligjit Nr. 48.2014, nga data e lëshimit të urdhërit të  
ekzekutimit 15.07.2021 deri në datën e ekzekutimit të detyrimit.

Ngarkohet shërbimi përbarimor me ekzekutimin e këtij vendimi.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës kërkuese.

U shpall në Tiranë më datë 15.07.2021.

SEKRETARE

KLEDJANA LLALLA

Shpenzime gjyqësore  
Tarifë kërkesë 200 lekë

